



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 164, Datë 24.11.2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 27.10.2022  
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës **27.10.2022**, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 27.10.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



## PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 27.10.2022

Kryesuesi i mbledhjes është zv. Kryetare e Këshillit znj. Edlira Mitre

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 21

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 21 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë:

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 15

### **Pika 1 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Keni ndonjë propozim për miratimin e rendit të ditës? Ndonjë ndryshim të rendit të ditës, ndonjë pikë? Profesore Irena po.

Këshilltare I.Nikaj: Kemi një ndryshim i cili është për shkak të ndryshimeve të natyrës ligjore që kanë ardhur në lidhje me këtë çështjen që lidhet me subvencionimin e interesave të kredisë.

Këshilltare A.Verushi: Të fillojë njëherë kryetarja me rendin e ditës pastaj të vazhdojmë me këto.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: E fillova.

Këshilltare I.Nikaj: Nuk është ndryshim në rendin e ditës, por është një rregullim që është bërë për shkak të kushtëzimit ligjor që ka ardhur dhe duhet të ndryshojë dhe të paraqitet apo të rregullohet në ditën e sotme që të ishte në përputhje me vendimarrjen bazë që është bërë, prandaj dhe ju vura në dijeni që kjo do të merret kështu në shqyrtim sot me këto ndryshimet që kanë ardhur dhe ju kërkoj mirëkuptim për ta vlerësuar si të tillë.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Bëhet fjalë për pikën 6 mbi miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit subvencionimi i interesave të kredisë, është një shtesë në ligjin e ksaj , dje e kemi folur me Mirelën. Pika 6 nuk ka ndryshim thjesht bazim në një ligj.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 2 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALEVE TË MBLEDHJES SË DATËS 29 SHTATOR  
2022.(me e-mail)

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

### **Pika 3 e rendit të ditës**

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE,DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUdhËN 1 – 30 SHTATOR 2022.

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.**

Këshilltare G.Koleci: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK. Për periudhën shtator, janë 53 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Përfitojnë 53 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 135.102 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 25 familje, në shumën 31.552 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 166.654 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor ,sipas kriterëve specifike të miratuara 15 familje, me fond prej 42.548 lekë .

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Nga këshilltarët e tjerë ka diçka për të shtuar, nga ekzekutivi?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 4 e rendit të ditës**

PËR RISHPËRNDARJEN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA.



**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)** znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Atëhere është propozuar përmes relacionit referuar listës së renditjeve të aplikantëve miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr.76 datë 18.08.2014 për renditjen e aplikantëve për banesa sociale me qira dhe mundësitë për rishpërndarje të apartamentëve dhe banesave me qira sociale miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr.82 datë 30.07.2020 “Për një ndryshim në V.K.B Nr.76 datë 18.08.2014 “Për renditjen e aplikantëve për banesat me qira sociale”, për shkak të lirimit të apartamenteve dhe qarkullimit të familjeve që përfitojnë strehim nga programe të tjera, krijohen mundësi për trajtimin e kërkesave të tjera për strehim, të cilat plotësojnë kriteret e vendosura me ligj për të përfituar nga programi social i strehimit “Banesat sociale me qira”. Kemi propozim për një qytetar i cili i plotëson këto kushte dhe i propozoj Këshillit Bashkiak ta miratojë këtë propozim që vjen nga Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe kryetaren e komisionit të strehimit.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Nga ekzekutivi kemi diçka ? Nga këshilltarët pyetje, diskutime?  
Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA.**

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)** znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Edhe në kuadër të këtij relacioni sipas përcaktimeve ligjore të cilat janë të paraqitura në pjesën e parë të relacionit është propozuar emri i një qytetareje që plotëson kërkesat parashtruar sipas ligjeve që janë miratuar në Republikën e Shqipërisë apo në nivelin vendor. I propozoj Këshillit Bashkiak për ta miratuar këtë relacion.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Kemi nga ekzekutivi?

Ekzekutivi M.Balli: Në lidhje me këtë programin e subvencionit të qirasë dua t'ju them sepse herë pas herë këtu do vijnë materiale të tilla. Ka qytetarë të cilët i plotësojnë kriteret për këtë lloj programi dhe ky është një program që ne e kemi fituar në bashkëfinancim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Për sa kohë kemi mundësi financimi për ta mbështetur ne do të sjellim herë pas here familje të cilat përfitojnë nga ky program.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Pyetje diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

### **Pika 6 e rendit të ditës**

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT," SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË.

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.**

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Një sqarim nga Mirela për atë shtesën e vogël që do ti bëjë materialit.

Ekzekutivi M.Balli: Atëhere ndryshimi vjen për shkak të një shkrese që na ka ardhur po nga Drejtoria e Strehimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me zgjerimin që i është bërë programit të subvencionimit të interesave të kredisë. Bashkia Korçë për vitin 2022 ka fituar kuota të reja. Janë 21 kuota të reja por që shoqërohen me vlera të tjera maksimale të kreditimit. Gjithashtu nga kuotat e vitit 2019-2021 ne kemi akoma kuota të lira dhe kjo ishte një pyetje që ne ja kemi drejtuar Ministrisë se si do të veprojmë dhe ditën e djeshme na ka ardhur përgjigje dhe na thuhet që për kuotat e lira që vijnë nga periudha 2019-2021 ne duhet ti referohemi vlerës maksimale që i përgjigjet atyre kuotave dhe ka një ndryshim, diferencë. Këtë duam ta reflektojmë tek tabela, sepse ishim referuar zgjerimit të programit për vlerat maksimale të kreditimit. Ndërkohë duke qënë se këto kuota i përkasin asaj periudhe dhe në vazhdim të korrespondencës dhe Ministrisë jemi të detyruar të reflektojmë këto ndryshime.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Faleminderit Mirela. Profesore?

Këshilltare I.Nikaj: Në tabelën që është realizuar nga drejtoria përkatëse ka një ndryshim në vlerë që është e lidhur me vlerën maksimale të apartamentit mbështetur në kuadër të rregullimeve ligjore. Pra ka ndryshim në vlerë kjo është, nga një vlerë maksimale që ishte parashtuar përpara ardhjes së këtij rregullimi, sot kemi një ndryshim të vlerës maksimale të apartamentit.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Nga këshilltarët kemi pyetje, diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0



## **Pika 7 e rendit të ditës.**

PËR MIRATIMIN E INICIATIVËS "KORÇA, BASHKI MIKE E FËMIJËVE.

**(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut)** znj Irena Nikaj, znj.Gerla Koleci, znj.Maria Dojçe, znj. Silvi Tare, znj.Etleva Tare, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Joan Deli.**(Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes)** z.Ervin Rota, z.Joan Deli, znj. Edlira Mitre, znj.Danjela Nasto, znj.Majlinda Duni.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Ju jeni në dijeni të programit Korça, Bashki Mike e Fëmijëve sepse ne herë pas here kemi pasur takime me znj Rudina që është përfaqësuese e ekzekutivit por edhe me përfaqësues nga Tirana që kanë bërë pyetësor edhe përpara pak kohësh është ndarë një broshurë me të dhënat për fëmijët për gjëndjen sociale të tyre, shkollat, kopshtet domethënë ishte parë gjëndja në total e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet shkollat në Bashkinë e Korçës. Besoj ato sot do na japin një pasqyrë të materialit që juve e keni përpara, e keni marrë materialin, shkurtimisht Rudina.

Përfaqësuese e ekzekutivit R.Lako: Bëhet fjalë për një iniciativë e cila është paraqitur disa kohë më përpara. Është një bashkëpunim i Bashkisë Korçë me mbështetjen e UNICEF dhe tani jemi në pragun e pranimit të kësaj iniciative dhe po ju parashtroj me çfarë ka të bëjë kjo iniciativë. Ideja është që të gjithë punojnë për fëmijët edhe institucionet edhe njësitë jo qeveritare. Ka në fokus fëmijët por duhet të kemi parasysh të gjithë punojnë për pjesën e tyre që të rritet dhe të forcohet kjo punë dhe të ketë një bashkëpunim dhe një koordinim dhe një monitorim sa më të mirë për mbarëvajtjen e këtij procesi, për të gjithë ata që kanë target grup fëmijët duhet të kenë një bashkëpunim të mirë dhe një forcim të vendimarrjes duke marrë për bazë të gjitha ato çfarë kanë të bëjnë me fëmijët. Ky lloj bashkëpunimi kjo lloj iniciative kërkon që të ndihmojë Bashkinë Korçë për integrimin në planet vendore për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët, sigurisht edhe të shtojë angazhimin e të gjitha strukturave që sigurojnë përfshirjen jo vetëm të fëmijëve por edhe të tjerë që janë pjesë për realizimin e objektivave në lidhje me fëmijët. Për faktin që jemi te Këshilli Bashkiak dhe ai është vendimarrës për pjesën e këtij plani, kësaj iniciative të madhe që është 3 vjeçare, Këshilli Bashkiak miraton planet dhe aktivitetet për të cilën ne jemi sot, do të miratojë dhe do të monitorojë të gjitha do të bëhet raporti vjetor në lidhje me çfarë është prezantuar që në plan, të cilat do raportohen në një periudhë kohe të caktuar. Këshilli Bashkiak të cilit do i bëhet dhe raportimi dhe bazë për këtë dëgjuesë do të jetë Këshilli Konsultativ i fëmijëve dhe i prindërve i cili është një grup që do të ngrejë zërin për të gjitha që ata kërkojnë nga organet vendimarrëse. Këshilli Bashkiak takohet me komunitetin drejtues një herë në vit dhe bëhet kjo dëgjuesë dhe dëgjesa për këto ndryshimet në bazë të këtyre përsëri kalojnë në Këshillin Bashkiak për tu miratuar nëse ka të tilla sipas nevojës të tyre. Plani i veprimeve është 3 vjeçar siç ja u thashë 2023-2025, ka 37 masa, bazohen në evidencat e situatës së fëmijëve të cilat i jep çdo strukturë e Bashkisë Korçë. Punon mbi dokumentat strategjike të qeverisë dhe bazohet në karakteristikat e vizionit që ka bashkia në lidhje me fëmijët. Përfshin aktivitetet dhe planet për të gjithë aktorët që punojnë me fëmijët dhe absolutisht në fund vendosim planin ekzistues. Nuk do të ribëhen gjërat por ato që janë do të koordinohen do të



sistemohen dhe do të plotësojnë njëra- tjetrën. Kjo është pak a shumë plani i veprimeve, pra ky është një plani që propozohet sot për Këshillin Bashkiak dhe pas një viti patjetër që për këtë plan do të jetë një raport në të gjitha strukturat që mbulojnë fushën e fëmijëve që ka Bashkia Korçë. Përsëri nëse ka ndryshime të ardhura nga Këshilli Konsultativ i fëmijëve , përsëri do të ketë ndryshime në plan dhe përsëri ai do të rinovohet nëse ka të tilla.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Nga komisioni, profesore Irena.

Këshilltare I.Nikaj: Unë e vlerësoj së tepërmi në mënyrë shumë pozitive qasjen që Bashkia Korçë ka ndaj një çështje të tillë kaq të rëndësishme siç është kujdesi ndaj fëmijëve edhe në projekte të tjera është treguar kjo qasje e bashkisë. Kjo i përket një perspektive relativisht të afërt e cila ndërton edhe më mirë se deri tani edhe në mënyrë të kujdesshme edhe në mënyrë të organizuar këtë përkujdesje ndaj fëmijëve duke krijuar edhe kushtet dhe mundësitë që fëmijët të kenë një zhvillim sa më normal, kompleks sipas kërkesave karakteristike të tyre dhe të gëzojnë vazhdimisht një mirëqënie mendore dhe fizike të mirë. E ftoj Këshillin Bashkiak që edhe pas paraqitjes që bëri Rudina ta miratojë një iniciativë ose nismë të tillë në lidhje me qasjen ndaj fëmijëve dhe veprimtarive dhe organizimive që ne bëjmë për të përmirësuar jetën e tyre .

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Përveç komisionit të mirëqënies sociale dhe strehimit rinisë, barazisë gjinore në këtë pjesë merrte pjesë dhe komisioni i arsimit sporteve dhe çlodhjes. Nëse dikush nga komisioni ka diçka ? Unë morra pjesë në komisionin e djeshëm bashkë me kolegët dhe unë jam e mendimit që profesore Irena e shpjegoi shumë mirë, raporti është i detajuar, çdo gjë është në vendin e vet sipas aktiviteteve të organizuara që është menduar që do të organizohen. Janë të detajuara me objektiva me qëllime atje ku do të arrihet me këtë nismë kaq të mirë. Mjafton që ne të japim votën dhe të fillojë zbatimi i këtij projekti shumë të mirë për fëmijët. Nëse ka pyetje ose diskutime?

Këshilltare E.Menkshi: Rudina unë doja të dija disa aktivitete që do të bëhen, më kryesoret, për të parë efektivitetin e kësaj iniciative dhe për të parë që në fund të kësaj iniciative çfarë përfitimi konkret do të kenë fëmijët apo grupmoshat që do të përfshihen në këtë iniciativë.

Këshilltare A.Verushi: Është në tabelë.

Këshilltare E.Menkshi: Unë nuk e kam.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Është komplet e detajuar prandaj thamë .

Këshilltare E.Menkshi: Edhe për mua, edhe për dikë tjetër që nuk e ka parë.

Përfaqësuese e ekzekutivit R.Lako: Atëherë siç e thamë është e detajuar me tabela ku ka qëllime objektiva dhe aktivitete për çdo objektiv. Janë 4 objektivat kryesore megjithatë unë po përmend për shembull restorantet miqësore të fëmijëve ku do të ketë vëndin e përshtatshëm për nënat me gji dhënie ose për ndërrimin e fëmijëve. Me sa di Bashkia në paketën fiskale jo ka favorizuar, por ka mbështetur restorantet miqësore të fëmijëve dhe uljen e taksave vendore dhe kjo është një gjë pozitive. Tjetër është krijimi i Këshillit Konsultativ të fëmijëve që unë e përmenda më parë ku janë pjesëmarrës fëmijë nga të gjitha shkollat e mesme dhe të 9-vjeçares. Ka një organizim të tillë një herë në vit ose edhe më shumë sipas nevojave dhe zëri i tyre nga dëgjesa do të ndikojë

në kërkesat që do ti bëhen Këshillit Bashkiak. Është bërë një botim statistikor nga UNICEF për çdo gjë që ka lidhje me fëmijët në planin social edukativ, kështu që të gjitha këto do të lidhen me një raport të veçantë, pra nëse duam të dhëna për fëmijët, të gjitha ato që punojnë me fëmijët do të jenë në një data-base ku do të këtë informacion në lidhje me ta, pra nuk do të këtë aktivitete të posatshme, por aktivitetet që zhvillohen tashmë nga të gjithë në strukturat e bashkisë nga shkollat nga qyteza e fëmijëve edhe nga fondacionet apo të gjithë që punojnë në lidhje me fëmijët do të jenë të koordinuara dhe do të kenë një llogaridhënie më të thellë në lidhje me këtë.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Nga këshilltarët kemi diçka tjetër, pyetje diskutime?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

**Hidhet në votim pika 8 e rendit të ditës.**

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR TË KËRKUAR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE."

**(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)**  
z.Gjergji Kristo.

Këshilltar Gj.Kristo: Bashkia Korçë në kuadër të zgjerimit të sipërfaqes së varrezave publike, kërkon të shpronësojë një sipërfaqe truall prej 2 189 m<sup>2</sup>, dhe nje sipërfaqe arë prej 30 000 m<sup>2</sup>, pasuri të cilat preken nga ky projekt harta e pasurive që kërkohen të shpronësohen, harta është bashkangjitur këtij relacioni. Konkretisht në pikën 7 neni 23 kërkohet shpronësimi për realizimin e projekteve dhe investimeve kombëtare ose vendore, në funksion të ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, kulturës dhe arsimit publik, si dhe të infrastrukturës, në shërbim dhe interes të publikut. Vlera e shpronësimit do të jetë 7 312 330 lekë. Vlera e Truallit; Sipërfaqe 2 189 m<sup>2</sup> x 1970 lekë/m<sup>2</sup> = 4 312 330 lekë. Vlera e Arës (Shtesë jugore); Sipërfaqe 30 000 m<sup>2</sup> x 100 lekë/m<sup>2</sup> = 3 000 000 lekë. Propozojmë që në kuadër të zgjerimit të varrezave , të japë miratimin Këshilli Bashkiak që të nisin procedurat e shpronësimit.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Nga këshilltarët, ekzekutivi? Kjo është vazhdimi i atyre që janë të reja Anxhela apo jo?

Ekzekutivi A.Dishnica: Vazhdimi i varrezave të reja.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0



## **Pika 9 e rendit të ditës**

### **KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.**

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Eva më thotë që nuk kemi kërkesa ose ankesa nga qytetarët.

Sekretare E.Naçi: Duhet të jetë një kërkesë që ka erdhur ditën e hënë nga shoqata "Dora Prindërore", ishte një djalë përfaqësues nga Këshilli Rinor.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Republika e Shqipërisë Shoqata "Dora Prindërore", kërkesë Këshillit Bashkiak. Shoqata "Dora Prindërore", për projektin me titull: "Më jep një shans të tregoj talentin tim", financuar nga Kongresi Rinor Shqiptar dhe mbështetur nga Bashkia Tiranë, në kuadër të projektit European "Tirana Kryeqyteti i të Rinjve 2022", i drejtohet Këshillit Bashkiak Korçë për të vendosur në rendin e ditës të takimit të muajit tetor gjë që kjo ishte e pamundur sepse ka ardhur me shumë vonesë, trajtimin e Ligjit 75/2029 "Për Rininë", në lidhje me fondin dedikuar të rinjve sipas këtij ligji, Kryetari Petrika Riza.

Sekretetare E.Naçi: 2029 i bie të jetë një lapsus.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Ndoshta , një përfaqësues nga të rinjtë. Kishim një djalë që na kërkoi fjalën , ku është? Na falni se po presim pak.

Sekretetare E.Naçi: Vazhdojmë me disa banorë të lagjes 4 të cilët janë paraqitur pa njoftuar, nuk na kanë njoftuar paraprakisht, megjithatë mund të njihemi dhe me kërkesën e tyre.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Ju lutem e fillojmë me një prezantim të shkurtër dhe pastaj problemi.

Qytetari: Ne jemi përfaqësi e lagjes nr.4 blloku i ish fushës së druve. Kemi bërë një kërkesë përpara më shumë se 20 ditësh. dhe nuk marrëm përgjigje.

Sekretetare E.Naçi: Në kërkesë ju i jeni drejtuar Këshillit?

Qytetari: Dhe Kryetarit të Bashkisë, dhe Këshillit Bashkiak. Nuk e di nëse ju ka ardhur.

Sekretetare E.Naçi: Jo nuk ka problem.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: S'ka gjë mund ta thoni dhe të vini në dijeni Këshillin.

Qytetari: Në lagjen tonë po bëhen disa investime, po investohet në rrugë. Ne jemi banorë prej gati 30 vitesh në atë lagje. Ajo është një lagje me një plan ubarnistik të miratuar përpara viteve 90, është një lagje ndoshta e vetmja në Shqipëri për mënyrën se si është formatuar me rrugë të gjera me lulishte me trotuare me të gjitha dhe nuk ka nevojë për asnjë lloj shpërblimi të them . Të gjitha ndërtimet që janë bërë atje janë konform rregullave, të gjithë banorët janë taksapagues të rregullt, fatmirësisht ka disa vite që kanë filluar po shtrohen disa rrugë në mënyrë shumë të

ngadalhtë, sivjet duket që punimet janë zgjeruar dhe një pjesë e mirë e lagjes është përfshirë në këto punime që po bëhen ndërkohë pjesa tjetër nuk preken nga këto punime . Janë 30 vite dhe 30 vite janë shumë. Kam qënë fëmijë kur kam ardhur në këtë lagje , djali im është më i madh sesa kam qënë unë kur kam shkuar, babai im është në moshë të shkuar, kur ka shkuar ka qënë sac jam unë. Një njeri kaq jeton 70-80 vjet, nuk mund të presim edhe një 30 vjecar tjetër në mënyrë që të na rregullohet rruga. Ne nuk po kërkojmë asnjë gjë, po kërkojmë një të drejtë bazike që është shtrimi i infrastrukturës , pjesa më e madhe e lagjes po bëhet dhe pjesë të caktuara mbeten ashtu . Ju si anëtarë të Këshillit Bashkiak, madje kam dhe disa foto të rrugëve, është një lagje me rregulla, të gjitha shtëpitë atje janë shumë moderne, janë miliona euro pasuri. Lagjia duhet të ishte përfunduar përpara shumë vitesh gjë e cila nuk ka ndodhur ende dhe disa banorë që kanë ardhur atje janë larguar për pjesën e kushteve , të vish atje nuk duhet të marrësh as foristradën, duhet të marrësh ndonjë fadromë që të kalosh. Askush nuk të diskriminohet në mënyrë të tillë , një pjesë e lagjes të ndërtohet dhe pjesa tjetër të ngelet siç është . Nga ana tjetër dua të theksoj dhe këtë që bashkia ka bërë shumë ndërhyrje në qytet, ne e shikojmë ka bërë shumë ndërhyrje ka izoluar pallate, çati mirë ka bërë. Ne nuk kërkojmë nga këto ne jemi të zotë, po ta marrësh lagjen një më një nuk besoj do të gjesh një familje që marrin ndihmë ekonomike, nuk duam ne ama një gjë e duam, rrugën e duam të bërë.

Qytetarja: Fëmijët tanë rrinë në baltë gjithë kohën.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Juve jeni bashkë?

Qytetari: Po jemi bashkë të gjithë, jemi një përfaqësi.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Për cilën rrugë po flasim?

Qytetari: Rruga "Kristaq Antoni", nuk e kanë futur në projekt, rruga që e mbyll lagjen. Ndoshta Këshilli Bashkiak duhet ti shikojë këto. Ne nuk duam salltanete. Bashkia erdhi dhe bëri kanalizimet mbas 30 vjetesh, atje ekzistonin disa kanalizime, banorët e kishin zgjidhur vetë. Kanë bërë vetë investim , janë gjëra që mund ti zgjidhim , rrugët nuk mund ti bëjmë . Duke zgjidhur rrugën dhe ata që kanë pronat e tyre nuk ndërtojnë më , merr vlerë e gjithë prona , dhe ata që kanë blerë tokën atje nuk vijnë sepse nuk ka infrastrukturën minimale, gjënë kryesore.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Nga ekzekutivi kemi ndonjë sqarim?

Qytetar : Demokracia duhet të jetë e njëjtë për të gjithë.

Qytetare: Vjen rruga deri tek lagjia jonë dhe për 30m del lart në rrugën kryesore.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Do kërkojmë një sqarim tani nga ekzekutivi të merrni një përgjigje , për momentin.

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Zona është një studim urbanistik i miratuar që në vitin 1989 dhe është bërë dhe projekti i rrjetit rrugor, i kanalizimeve i të gjithave. Problemi ishte që bashkia nuk ka pasur fonde për të investuar, para 4 vjetësh nisëm investimet në atë zonë me aq fonde sa kishte bashkia dhe nisëm nga rrugët më afër qytetit dhe po vazhdonim gradualisht , ndërkohë nga Fondi Shqiptar i zhvillimit pasi aplikuam për shtrime rrugësh na u afrua kjo mundësi, por deri aty ishte vlera në lekë që kishte Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në vazhdim ne do të vazhdojmë të aplikojmë për ta mbyllur, e kemi prioritet që atë lagje ta mbyllim sepse nga ana morale kemi përgjegjësi sepse kjo zonë ndryshe nga zonat infomale që nuk na kanë mbetur, kjo zonë është zhvilluar me



rregulla në të gjitha aspektet, dhe nuk është zonë informale por është zonë me zhvillim urbanistik, kështu që përpara se të ndërhyjmë në zonat informale duhet të mbyllim këtë zonë.

Qytetarja: Po ne jemi në këtë zonë.

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Po jeni në këtë zonë, kaq fonde kishte dhe deri aty arritëm.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Flisni me rradhë ju lutem që t'ju dëgjojmë të gjithë.

Qytetarja: Edhe fëmijët tanë kanë të drejta, siç kanë fëmijët tënd, të zonjës, të të tjerëve këtu që kemi respekt.

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Më fal, këtë po ju themi .

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Zonja Zhani besoj se e sqaroi ashtu siç duhet.

Qytetarja: Ne nuk po pretendojmë të na bëjë asgjë tjetër, thjesht një asfalt.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Juve doni një asfalt që ta bëjme sot dhe nesër të prishet , kjo nuk është e rregullt, prandaj zonja po thotë të marrim fondin dhe ta bëjmë ashtu siç duhet. Ajo ka në dorë të gjithë urbanistikën e qytetit.

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Sa për dijeni në 89 atë studim të asaj zone e kam bërë unë sepse sapo kam dalë nga bankat e shkollës. Puna e parë që kam bërë ka qënë studimi i asaj zone.

Sekretetare E.Naçi: Të lutem flisni me rradhë , kur flasim të gjithë nuk kuptohet çfarë thuhet.

Qytetarja: Si ka mundësi që arrin asfaltimi deri këtu dhe për 30m nuk del deri në krye. Jemi 6 familje Kreka dhe ndalet atje asfaltimi.

Këshilltare A.Verushi: Mos e merrni personale se janë këto familje dhe ndërpritet rruga atje. Nëse dëgjuat me vëmendje dhe ka shumë të drejtë vajza që thotë të dëgjojmë njëri-tjetrin do ta kuptonit përgjigjen që ju dha drejtoresha. Është një lagje prioritare, së dyti me buxhetin që ka bashkia kaq kishte mundur të investonte në atë zonë. Po bëhet përpjekje për të gjetur donatorë , një nga donatorët është edhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit i cili duke qënë se jemi në mbyllje të këtij viti sepse dhe ata kanë planet e tyre kanë nxjerrë një fond për ti ardhur në ndihmë Bashkisë Korçë për këtë zonë. Unë personalisht edhe në cilësinë e këshilltares do ti kërkoj Bashkisë që me buxhetin e vitit që vjen po njëkohësisht edhe me këta donatorë siç është Fondi Shqiptar i Zhvillimit ku bashkia në mënyrë të vazhdueshme aplikon në këto projekte për shtrimin e rrugëve brënda lagjeve të qytetit, sepse dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka program apostafat për lagjet e qyteteve, pra shtrimin e rrugëve për lagjet në zonat urbane dhe në zonat rurale. Bashkia aplikon, del fituese dhe merr fond. Ashtu siç e fitoi për këtë periudhë aq fond ka pasur Fondi Shqiptar i Zhvillimit për këtë vit, për vitin që vjen patjetër që do të ngulmohet maksimalisht. E para edhe në drejtim të donatorit po së dyti edhe bashkia me buxhetin e vitit do ta ketë në vëmendje sepse s'mund ta lerë prapë kështu, të vejë rruga deri tek x shpi dhe të ngelet 5-6 shtëpi të tjera. Askush nga ne, të gjithë këtu që jemi në këtë sallë nuk e dëshiron këtë gjë. Personalisht edhe njëherë e thashë do ta ngre si shqetësim tuajin edhe në momentet ku do të diskutojmë buxhetin dhe bashkia do të dalë me buxhetin përpara Këshillit për ta miratuar por njëkohësisht edhe me pjesën tjetër me Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Qytetari: Ju lutem mund të flas diçka? Sa herë që bëhen zgjedhjet këtu, zgjidhje vendore.

Këshilltare A.Verushi: Mos e mendoni si të tillë.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Ju lutem se e morri fjalën zotëria. Zonjë e morri fjalën zotëria.

Qytetarja: Komshiu im është zotëria.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Po le të jetë, nuk ka të drejtë ai të flasë, urdhëro zotëri.

Qytetari: Në këto 30 vite janë bërë 7 herë zgjedhje nga 2 herë me lokale me vendore venë 14 herë . Gjithmonë që bëhen zgjedhjet vijnë me premtimet e tyre, si të majtët si të djathtët ne duam të na bëhet rruga nuk shikojmë ngjyrat e partisë e bardhe, e kuqe, jeshile. Nga tërë këto vite premtimet janë të shumta dhe vepra asnjë, para 2-3 vitesh që u bënë vendoret na sollën ca makina me çakull gjoja sikur na zbukuruan, do bëjmë këtë do bëjmë atë dhe asgjë nuk bënë, kjo në sytë tonë është shumë e rëndë është diçka që na vret shpirtërisht dhe ndihemi shumë të distancuar nga pjesa tjetër e shoqërisë .

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Juve keni shumë të drejtë dhe ne pavarësisht mendimeve që mund të kemi , jemi të gjithë këshilltarë dhe ju japim të drejtë, besoj që jemi kthyer në një mëndje.

Qytetari: Ja u japim votën që të na shërbeni neve, juve merrni pozitat e larta , rrogat shumë të mira dhe neve na harroni.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Dhe ne qytetarë si puna juaj jemi, dhe ne kemi defekte përpara shtëpive tona.

Qytetari: Unë të jap votën, të ngre në pedestal, ti shkon në pedestal dhe mua më harron.

Këshilltare A.Verushi: Ke shumë të drejtë në momentin kur thua që ne ju japim votën, se dhe ne të gjithë që jemi këtu jemi të votuar nga ju , se po të mos votonit ju ne nuk do të zgjidheshim. Unë personalisht për herë të parë e dëgjoj sot këtë lloj shqetësimi dhe zotohem këtu për ta ndjekur deri në fund dhe për të dhënë një përgjigje, mund të mos jetë zgjidhja sot por të jesh i sigurt që një përgjigje do ta kesh nga unë.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Ne nuk e vemë në dyshim fjalën tuaj. Shiko këshilli është në krah të njerëzve. Tani në qoftë se dëgjuam një premtim nga Ana, gjithësecili nga këshilltarët ka dhënë këtë lloj premtimi. Dëgjojeni përfundimisht fjalën e zonjës Zhani.

Qytetari: Meqë Zhani është autorja e projektit, është edhe në fund të karrierës.

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Do ta mbyll atje.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Po keni shumë të drejtë, premtimi i zonjës Zhani ishte ky është bërë 90% dhe 10% do bëhet se s'bën .

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Nuk do dal në pension pa e mbyllur atë zonën.

Këshilltare I.Nikaj: Është i vërtetë shqetësimi i Erionit, unë e ndava menjëherë me drejtoreshën e urbanistikës që kur më tha dhe e morra dhe përgjigjen, megjithatë e dha sot dhe është shumë mirë, unë e kam parë atë zonë dhe ashtu siç thatë dhe ju është transformuar dhe është një nga zonat që ke qejf ta shikosh dhe nga sipër jo vetëm atje. Natyrisht që jam krejtësisht dakord me banorët që ajo duhet të mbarojë jo vetëm si një premtim por dhe si diçka që i kontribuon së tepërmi cilësisë dhe standarteve , prandaj dhe jam krejtësisht dakord me ju, sigurisht që mjetet



financiare nuk janë gjithmonë në dispozicion për tu bërë gjithmonë më e mira e mundshme, të jeni të sigurt që kushdo nga ne e dëshiron këtë, por ja që ta marrim këtë vlerësim dhe këtë premtim dhe të shpresojmë që sa më shpejt ajo të realizohet.

Këshilltari E.Menkshi: Dhe unë e kam parë, Erionin e kam koleg dhe e kam parë edhe zonën dhe keni të drejtë. Rruga është jo në gjëndje të mirë, nuk besoj se kërkon shumë dhe në fonde financiar dhe në të gjitha. Pse jo atje jeton një komunitet.

Qytetari: Njerëz të nderuar.

Këshilltari E.Menkshi: E vërtet është zotëri, në këtë kontekst unë shpreh solidaritetin dhe besoj se edhe herë tjetër në këshill ne do ta ndjekim dhe do ta shikojmë këtë problem pasi kolegu ka vite që thotë moj Eda kemi një problem atje, kështu që ne zotohemi që do ta ndjekim.

Qytetari: Komshiu jeton në greqi bashkë me bashkëshorten e ka patur mundësi që të ikin, por nuk do e do atë vend, e ka ndërtuar me duart e tija.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Tani fjalën e znj Zhani e keni, do bëhet. Faleminderit për shqetësimin që na përcollët dhe shpresojmë që do të realizohet. Vazhdojmë me djalin.

Përfaqësues i organizatës "Dora Prindërore": Përshëndetje të gjithëve, i uroj punë të mbarë këshillit. Si pjesë e këshillit rinor të strukturës së re të sapo formuar në bazë të ligjit për rininë 75/2019 dhe si anëtar i organizatës rinore "Dora Prindërore", me kryetar z.Petrika Riza, në kuadër të projektit "Më jep një shanc të tregoj talentin tim" janë identifikuar të rinj të talentuar në këtë fushë dhe mbështetur në ligjin për rininë 75/2019 ekzaktësisht tek financimi i politikave, programeve apo projekteve rinore, neni 15 pika b) për faktorët e financimit nga buxheti rinor parashikohet një fond dedikuar të rinjve sipas këtij ligji. Kërkesa jonë konsiston në atë që duam që Këshilli Bashkiak të mbështesë atë që është lejuar me një fond në bazë të këtij ligji në aspektin e artit dhe kulturës. Fondi presupozohet të përdoret prej tyre, për të rinj të talentuar në shkencë sport mbi bazën e ideve dhe projekteve konkurruese.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Do të merrni pjesë në dëgjesat publike për buxhetin e vitit të ardhshëm, do të jepni projektet tuaja të detajuara me qëllim që edhe bashkia ti marrë parasysh kërkesat.

Ekzekutivi A.Dishnica: Këtë kërkesën nuk e di e keni dorëzuar në mënyrë zyrtare në bashki?

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Jo vetëm këshillit ja kanë drejtuar.

Sekretare E.Naçi: Tek ne e kanë dërguar me e-mail ditën e hënë.

Ekzekutivi A.Dishnica: E mira është të vihet në dijeni dhe drejtorja e financa meqënëse është duke hartuar dhe buxhetin.

Zv. Kryetare e Këshillit E.Mitre: Kemi pika të ndryshme nga këshilltarët?

Këshilltari I.Nikaj: Së pari është një shqetësim këtu në ndërhyrjet që është bërë, pra heqja e mbeturinave nga ndërhyrja që është bërë në një ndërtesë kolektive në fillim të rrugës Vaskë Dushku sepse është bërë ndërhyrje nga Fondi Shqiptar për çatit, në atë ndërtesë nuk janë hequr mbeturinat, në hyrje të rrugës Vaskë Dushku është një ndërtesë dhe aty është shqetësimi i banorëve, së dyti kam një shqetësim nga banorët e pallatit këtu që keni afër, që rrinë këtu tek gjëndja civile, atje ka dëmtime nga tërmeti dhe unë e bisedova me drejtoreshën e urbanistikës

dhe më tha që duhet të vijnë vetë banorët që të bëjnë një kërkesë. Ndoshta keni ndonjë numër kontakti, unë thjesht e morra si shqetësim dhe po e paraqes .

Ekzekutivi A.Dishnica: Ta bëjnë një kërkesë tek informacioni. Të dërgojmë një përfaqësues të rajonit.

Këshilltare I.Nikaj: Dakord por unë kam kontakte me atë, do ti them që ti verë në lëvizje këta për ta bërë këtë shqetësim, sepse ata nuk i kanë mundësitë për të ndërhyrë me mjetet e tyre dhe ndoshta gjendet mundësia. Këto janë përsa i përket asaj, për të shpjeguar për çështjen e abstenimit , në procesverbal është shkruar se është mbledhur komisioni këshillimor për figurën e parë që ishte për "Qytetar Nderi", në fakt komisioni këshillimor për këtë figurë nuk është mbledhur.

Sekretare E.Naçi: Për Zhulianën.

Këshilltare I.Nikaj: Është tjetër gjë , po ja u lexoj siç e keni bërë: Pra relacioni përgatitet nga drejtoria përkatëse thoni ju , komisioni këshillimor u mbledh për rastin dhe nuk e keni sqaruar, në fakt për rastin e Kristos ishin 2 anëtarë thoni dhe nuk mund të ishin sepse kishin ç'kishin. Pra ngatërohet komisioni 1 me komisionin 2 .

Sekretare E.Naçi: Nuk është mbledhur po, prandaj kemi përcaktuar që ishin 2 anëtarë e para. Komiteti Këshillimor për Kristo Floqin ishte në tejkalim të të gjitha afateve, kështu që në momentin që një komision nuk mbledhet ne nuk do të thotë që nuk do ta vazhdojmë procedurën.

Këshilltare I.Nikaj: Unë po diskutoj çfarë është zbardhur në procesverbal ashtu siç s'ka ndodhur, pra thotë kryetari : dakordësia është dhënë për këtë , atëherë komisioni si propozon ta kalojmë për votim? Pra ne në fakt për figurën e parë nuk kemi dhënë dakordësi.

Sekretare E.Naçi: Dakordësinë e kujt? Komiteti Këshillimor nuk u mbledh e thamë atë. Ju i thatë profesor Pandit në mbledhje atë ditë që të përcaktosh motivacionin.

Këshilltare I.Nikaj: Jo nuk është kështu.

Sekretare E.Naçi: Po , në mbledhjen e Komitetit? Profesor se ju ishit, ju lutem mund ta shpjegoni situatën.

Këshilltar P.Bello: Ne jemi zgjedhur këtu të pengojmë të këtilla gjëra, apo të vlerësojmë. Unë nuk kam çfarë të diskutoj më as për rastin e Zhuljana Jorganxhiut as për Kristo Floqin. Nëse dikush nuk ka mundësi të vijë , unë nuk mund ti pengoj, ne atë ditë me profesore Irenën kemi formuluar motivimin përse këta njerëz vlerësohen nga qyteti nga Këshilli Bashkiak nga Bashkia e Korçës, kështu ishte, kush erdhi erdhi, kush nuk erdhi.

Këshilltare I.Nikaj: Mirë dakord po ne kemi bërë për Zhuljana Jorganxhi, jo për personalitetin tjetër. Këtu në procesverbal është shfaqur në mënyrë tjetër.

Sekretare E.Naçi: Po pra dhe unë kam sqaruar ditën e mbledhjes profesore që ishin dy anëtarë.

Këshilltar P.Bello: Të lutem, këshilltarët janë këshilltarë, vendimin e merr Këshilli Bashkiak nuk e marrin këshilltarët , këshilltarët janë të nderuar të vijnë kur nuk kanë mundësi.

Këshilltare I.Nikaj: Edhe njëherë unë nuk po diskutoj vullnetin e këshilltarëve, unë po ju them që ne caktuam një komision këshillimor që nuk u mbledh dhe nuk doli me vendim.



Këshilltar P.Bello: Po nuk erdhën, ata nuk marrin vendim, ata pyeten dhe nuk marrin vendim, nëse marrin vendim ata nuk quhen këshilltarë, komision këshillimor.

Këshilltare I.Nikaj: Po komisioni këshillimor përse është ngritur?

Këshilltar P.Bello: Për të diskutuar.

Sekretare E.Naçi: Për të vendosur motivacionin.

Këshilltar P.Bello: Nuk merr vendimin komisioni këshillimor, ky është koncept, nëse e bëjmë ndryshe hajde ta riformulojmë dhe e quajmë ndryshe . Këtu ka komision nuk po them tani se kush është, ne jemi në këtë komision për të marrë vendimi dhe as Komisioni se merr i vetëm, vendimin e merr Këshilli Bashkiak dhe në emër të bashkisë, të të gjithë qytetit, jo të dikujt që s'ka mundësi të vijë në një mbledhje një ditë.

Këshilltare I.Nikaj: Dhe njëherë Komisioni Këshillimor u caktua , komisioni i titujve gjithashtu, nuk u mblodh komisioni i titujve tani ju meqenëse Komisionit Këshillimor nuk i jepni asnjë rol.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

**KRYETARI**

**ERJON NEXHIPI**

